



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

Njoftim Paraprak Përqendrimi

Rasti: Përftimi i kontrollit të vetëm të shoqërisë Intelligent Apps GmbH nga Daimler AG.

Me shkresën Nr.225 Prot., datë 03.04.2018 Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin të ndodhur midis palëve blerëse Daimler Mobility Services GmbH, pjesë e grupit Daimler AG dhe palës shitëse HNH Group Ltd¹, e cila zotëron aksione të Intelligent Apps GmbH, ku kjo e fundit është shoqëria target, në të cilën do të ndodhin ndryshimet e aksionareve.

Palët pjesëmarrëse në transaksion:

Blerësi : *Daimler Mobility Services GmbH*, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, pjesë e Grupit Daimler AG, me kapital 25,000 Euro, me objekt të aktivitetit planifikimin, zhvillimin, funksionimin dhe marketingu i koncepteve të lëvizshmërisë, si p.sh sisteme të automatizuara për qera të makinave, rrjete lëvizshmërie për ofrimin e shërbimeve lëvizëse dhe shërbime të tjera në fushën e lëvizshmërisë ose në fusha si sigurimi ose lehtësimi i lëvizshmërisë dhe sigurimin e shërbimeve të planifikimit, këshillimit, këshillimit dhe shërbimeve të tjera në fushat e lartpërmendura.

Daimler AG, shoqëri aksionare me kapital 3.069.671.921,06 Euro, është prodhues global i veturave të cilësisë shumë të lartë dhe prodhuesi më i madh në botë i mjeteve lëvizëse komerciale. Ndarjet e aktivitetit të Daimler janë veturat Mercedes-Benz; kamionët Daimler, Fugonët Mercedes Benz, Autobusët Daimler dhe Shërbimet Financiare Daimler.

Shitësi: *HNH Group Ltd*, kompani e themeluar sipas legjislacionit të Anglisë dhe Wellsit me adresë biznesi të regjistruar në Cannon Place, 78 Cannon Street, London, EC4N 6AF, Mbretëria e Bashkuar, regjistruar në regjistrin e shoqërive vendase me numër 074777716.

Ndërmarrja Target: *Intelligent Apps GmbH*, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, (Mytaxi) në Hamburg, Gjermani, me objekt të aktivitetit të shoqërisë operimin e një shërbimi taksie kombëtare dhe ndërkombëtar si dhe blerja, marketingu dhe shpërndarja e produkteve të lidhura direkt dhe indirekt me shërbimet si dhe me shërbime të ngjashme.

¹ Hailo Network Holdings Ltd

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.